REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKU
Nr/Br. 939/20
Datë/Datum. 24.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr.939/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Blerim Kryetar z. Nuhi Paqarizi Referues z. Goran Milenkovic, Anëtar si dhe duke u bazuar në nenin 28 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, dhe nr. të protokollit 83/20 të dt: 03.03.2020, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 19 NËNTOR 2020, të parashtruar nga Grupi i operatorëve ekonomik: "VB INVEST" SH.P.K & "DTMINING" SH.P.K & "GËRLICA-COMPANY" SH.P.K -Prishtinë, për tërheqje të ankesës me numër 939/20 të datës 13.11.2020,lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi Asfaltimi i rrugëve në Fshatrat Terstenik I, Terstenik II, Shtutic, Verbovc, Polluzhë, Dobroshec, Qikatovë, e vjetër, Gllanasellë, Godanc, Gradicë dhe Likoshanë-Faza e dytë-Projekt dy vjeqarë" me nr te prok: 611-20-6196-5-2-1 iniciuar nga AK/ – "KK-GLLOGOC", me datën 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.<u>APROVOHET</u>, kërkesa e datës 13 NËNTOR 2020 e Grupit të operatorëve ekonomik "VB INVEST" SH.P.K & "DTMINING" SH.P.K & "GËRLICA-COMPANY" SH.P.K -Prishtinë, për tërheqje të ankesës me numër 939/20 të datës 13.11.2020,lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi Asfaltimi i rrugëve në Fshatrat Terstenik I, Terstenik II, Shtutic, Verbovc, Polluzhë, Dobroshec, Qikatovë, e vjetër, Gllanasellë, Godanc, Gradicë dhe Likoshanë-Faza e dytë-Projekt dy vjeqarë" me nr te prok: 611-20-6196-5-2-1 iniciuar nga AK/ – "KK-GLLOGOC".

II.<u>NDËRPREHET,</u> procedura e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik: " VB INVEST" SH.P.K & "DTMINING" SH.P.K & "GËRLICA-COMPANY" SH.P.K -Prishtinë pasi që është parashtruar kërkesë për tërheqje të ankesës me numër 939/20 të datës 13.11.2020,lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rehabilitimi Asfaltimi i rrugëve në Fshatrat Terstenik I, Terstenik II, Shtutic, Verbovc, Polluzhë, Dobroshec, Qikatovë, e vjetër, Gllanasellë, Godanc, Gradicë dhe Likoshanë-Faza e dytë-

Projekt dy vjeqarë" me nr te prok: 611-20-6196-5-2-1 iniciuar nga AK/ – "KK-GLLOGOC".

III.I LEJOHET, autoritetit kontraktues, që të vazhdoj më tutje me këtë aktivitet të prokurimit përkitazi me këtë ankesë, ndërsa nëse ka ankesë tjetër, ajo vazhdon të shqyrtohet në mënyrë të rregullt dhe aktiviteti i prokurimit mbetet i pezulluar ashtu siç parashihet në nenin 112 paragrafi 1 të LPP-së.

IV. Meqenëse parashtruesi i ankesës tërhiqet nga ankesa dhe se kjo ankesë nuk ka hyrë në shqyrtim nga ana e OSHP-së, në pajtim me nenin 28 të Rregullores së punës së OSHP-së, nr. 01/20 me numër te protokollit 83/20, këtij OE i bëhet kthimi i depozitës të deponuar me Rastin e Akesës.

ARSYETIM

Grupi i Operatorëve Ekonomik: "VB INVEST" SH.P.K & "DTMINING" SH.P.K & "GËRLICA-COMPANY" SH.P.K -Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 13.11.2020, me nr. 939/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rehabilitimi Asfaltimi i rrugëve në Fshatrat Terstenik I, Terstenik II, Shtutic, Verbovc, Polluzhë, Dobroshec, Qikatovë, e vjetër, Gllanasellë, Godanc, Gradicë dhe Likoshanë-Faza e dytë-Projekt dy vjeqarë" me nr te prok: 611-20-6196-5-2-1 iniciuar nga AK/ – "KK-GLLOGOC".

Me datën 13.11.2020, është njoftuar autoriteti kontraktues nga OSHP-ja, për pranimin e ankesës së lartpërmendur në mënyre që të behet pezullimi i aktivitet të prokurimit në fjalë.

Grupi i Operatorëve ekonomik: "VB INVEST" SH.P.K & "DTMINING" SH.P.K & "GËRLICA-COMPANY" SH.P.K -Prishtinë, me datën 19 Nëntor 2020, përmes email-it ka deponuar në OSHP, kërkesën për tërheqjen e ankesës, lidhur me tenderin me titull "Rehabilitimi Asfaltimi i rrugëve në Fshatrat Terstenik I, Terstenik II, Shtutic, Verbovc, Polluzhë, Dobroshec, Qikatovë, e vjetër, Gllanasellë, Godanc, Gradicë dhe Likoshanë-Faza e dytë-Projekt dy vjeqarë" me nr te prok: 611-20-6196-5-2-1,

Sqarimi i GOE: Në lidhje ma ankesën e datës 13 nëntor 2020, GR OE "VB INVEST, DT MINING SHPK dhe GËRLICA COMPANY SHPK", për projektin me titull "*ASFALTIMI I I RRUGËVE NË FSHATRAT TERSTENIK I, TERSTENIK II, SHTUTIC, VERBOVC, POLLUZHË, DOBROSHEC, ÇIKATOVË E VJETER, GLLANASELLË, GODANC, GRADICË DHE LIKOSHAN –Faza e dytë –*

Projekt dy vjeqarë." dhe me numër prokurimi 611-20-6196-521 Ju njoftojmë që tërhiqemi nga kjo procedurë ankimorë për shkak se tashme jemi ne fund vit dhe kemi disa projekte në përfundim e sipër, andaj nuk kemi mundësi që ta realizojmë edhe punimet në këtë projekt, edhe në rast se përgjegjësja juaj ndaj ankesës sonë do të ishte në favorin tonë Shpresojmë në mirëkuptim nga ana juaj dhe të vazhdojmë me procedurat e mbylljes së ankesës dhe kthimit të tarifës së paguar nga ana jonë.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave,njoftimi për kontratë , ankesa e operatorit ekonomik, , kërkesën e OE ankues te datës 19.11.2020 dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues sqaron se Grupi i OE-ve: "VB INVEST" SH.P.K & "DTMINING" SH.P.K & "GËRLICA-COMPANY" SH.P.K -Prishtinë datën 19.11.2020, përmes e-mail-it ka deponuar në OSHP, kërkesën për tërheqjen e ankesës së datës 13.10.2020, me nr. protokolli 939/20, lidhur me tenderin me titull: "Rehabilitimi Asfaltimi i rrugëve në Fshatrat Terstenik I, Terstenik II, Shtutic, Verbovc, Polluzhë, Dobroshec, Qikatovë, e vjetër, Gllanasellë, Godanc, Gradicë dhe Likoshanë-Faza e dytë-Projekt dy vjeqarë" me nr te prok: 611-20-6196-5-2-1 iniciuar nga AK/ – "KK-GLLOGOC".

Paneli shqyrtues pasi shqyrtoj kërkesën e operatorit ekonomik ankues, konstatoj se kërkesa e OE ankues për tërheqje nga ankesa me numër te protokollit 939/20, është dorëzuar në OSHP me datën 13.11.2020, periudhe kjo kohore në te cilën OSHP ende nuk e ka pasur në Shqyrtim.

Andaj OSHP aprovon kërkesën e OE ankues për tërheqje nga ankesa, mirëpo në pajtim me nenin 28 paragrafi 1 të Rregullores së Punës se OSHP-së nr. 01/20, me numër të protokollit 83/20, ankuesit i behet kthimi i tarifës lidhur me ankesën me numër të protokollit 939/20 të datës 13.11.2020, nga fakti se ankuesi ka bere kërkesë për tërheqje para se ankesa të hyj në shqyrtim dhe duke u bazuar në nenin 28 paragrafi 1 i Rregullores së Punës se OSHP-së nr. 01/20, me numër të protokollit 83/20 specifikon:

Pala mund ta tërheqë ankesën në çdo kohë. Në rast se ankesa tërhiqet para shqyrtimit të ankesës dhe/ose emërimit të ekspertit shqyrtues dhe para pranimit të akt-ekspertizës, do të bëhet kthimi i tarifës

së ankesës. Në qoftë se ankuesi e tërheq ankesën pas emërimit të ekspertit shqyrtues dhe pranimit të akt-ekspertizës atëherë bëhet konfiskimi i tarifës në emër të shpenzimeve procedurale.

Paneli shqyrtues i OSHP-së, pasi shqyrtoj kërkesën e operatorit ekonomik ankues, të njëjtën e aprovoj si të bazuar, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

z. Blerim BINA

Vendimi i dërgohet:

1x1 AK-"KK-GLLOGOC".

1x1 GOE-"VB INVEST" SH.P.K & "DTMINING" SH.P.K & "GËRLICA-COMPANY" SH.P.K -Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim ne ueb faqe të OSHP-së.